

Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit të punës 03/L-212, si dhe UA Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nent 5,7,8, Statutit të Ndërmarrjes dhe rregullorëve të brendshme, Ndërmarrja Publike Lokale “Eko- Llapi” Sh.A. Podujevë shpallë këtë:

## **KONKURS**

### **Për plotësimin e vendeve të lira të punës**

#### **Mirëmbajtës/e i hapsirave të jashtme publike- Tetë (8) pozita**

**Titulli i Punës:** Mirëmbajtës/e i hapsirave të jashtme publike

**Raportimi:** Drejtuesit/es të njësisë operative

**Tetë (8) Pozita:** Mirëmbajtës/e i hapsirave të jashtme publike

**Vendi i punës:** NPL “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë

**Orari i punës:** 40 orë në javë

**Niveli i pages:** 6

**Periudha provuese:** 6 muaj

#### **Detyrat e përgjegjësitë:**

- a) Është përgjegjës/e për realizimin e objektivave të caktuara nga Drejtuesi i njësisë;
- b) Kordinon punët me punonjësit/et tjerë/a së bashku me përgjegjës/inë e grupit në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme që kanë të bëjnë me Njësinë
- c) Merr pjesë në mbledhjet e rregullta ku është i/e thirrur për nevojat e Njësisë
- d) Është përgjegjës/e për pastrimin e njësive të caktuara nga Drejtuesi i njësië;
- e) Mban evidencë të njësive të pastruara dhe e dorëzon këtë raport në baza javore te Drejtuesi i Njësisë;
- f) Për punët dhe detyrat e shtruara i përgjigjet Drejtuesit të njësisë;

- g) Porositë për materiale i bën më herët dhe i specifikon në detaje sipas kërkesës;
- h) Materialet të cilat nuk furnizohen sipas kërkesës ka të drejtë t'i kthejë mbrapa;
- i) Kujdeset për mjetet e punës dhe raporton për defektet e tyre;
- j) Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar,
- k) Drejtuesi i njësië mund ta ngarkojë me detyra tjera sipas nevojës së Ndërmarrjes;
- l) Në rast mungese të punonjësve tjerë, me urdhër të Drejtuesit të njësisë mund të zëvendësojë dhe të kryej detyra tjera,
- m) Është i obliguar të ketë sjellje korrekte duke respektuar kolegët,
- n) Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve dhe trotuareve,
- o) Mirëmbajtja dhe pastrimi i Lapidarëve dhe Pllakave përkutimore
- p) Krasitja ,mbjellja, ujitja dhe mirëmbajtja e trupave (drunjëve) dekorativ
- q) Mbjelljen, ujitjen dhe mirëmbajtjen e luleve gjatë sezonit veror
- r) Spërkatja me herbicide për baroja të këqija në trotuar dhe skaje të rrugës
- s) Bënë pastrimin e përrockave dhe lumenjëve
- t) Detyra tjera relevante

#### **Aftësitë:**

- Shkathtësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmoj fleksibilitet në punë;
- Njohje të shkëlqyer të materialeve dhe mjeteve të punës që kanë të bëjnë me pastrim;
- Të ketë kujdes të shtuar dhe të respektojë normat për sigurinë në punë;
- Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në objekte të ndryshme;
- Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në të gjitha kushtet atmosferike.
- Të ketë etikë dhe integritet në punë.

#### **Dokumentet e kërkuara :**

- Aplikacioni i NPL;
- Dëshmitë për Shkollim - Shkolla Fillore ose e Mesme,
- Preferohet përvojë e punës se paku 1 vit,
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj),
- Kopjen e letërnjoftimit,

## **Procedura e Konkurimit**

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e NPL “Eko-Llapi” Sh.A Rr. “Zahir Pajaziti” Podujevë (Ish Objekti i Komunës) Nr.19-Kati I, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues. Dokumentacioni i mbyllur në zarf dorëzohet në NPL “Eko-Llapi” Sh.A Rr.

**“Zahir Pajaziti” Podujevë (Ish Objekti i Komunës) Nr.19-Kati I,**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të njoftohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e Komunës, pas mbylljes së konkursit.

### **Sqarim:**

Fillimi i punës për vendin e cekur më lartë, nuk do të jetë domosdoshmeri pas përfundimit të procedurave të rekrutimit të këtij konkursi por në vartësi të nevojave të Ndërmarrjes

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

**Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet që para nënshkrimit të kontratës të sjellë certifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psiqike.**

Shpallja është e hapur që nga data 26.04.2024 deri më 10.05.2024

NPL “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë

Kryeshf Ekzekutiv

